REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 214, datë 31.10.2018

PËR
DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN NR. 58, DATË 30.06.2015 "MBI MASAT E VIGJILENCËS SË DUHUR DHE TË ZGJERUAR NGA SUBJEKTET E LIGJIT MBI PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT", E NDRYSHUAR.

Në zbatim të rekomandimeve të lëna nga Komiteti MONEYVAL i Këshillit të Evropës (KiE), me
propozim të Departamentit të Çështjeve Juridike, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloren nr. 58, datë 30.06.2015 "Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", e ndryshuar.
2. Ngarkohen Departamentet përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR **DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

Pajtim MELANI **Ervin KOÇI**

Në Rregulloren nr. 58, datë 30.06.2015 "Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", e ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në nenin 8, pika 3, në fund të paragrafit shtohet:

"…si dhe përgatisin një program trajnues të vazhdueshëm për personin përgjegjës".

2. Rregullores i shtohet *"Udhëzuesi për matjen e rrezikut nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit".*

3. Aneksi I, titullohet *"Udhëzime specifike për tregun e sigurimeve dhe letrave me vlerë":*

3.1 në pikën A), paragrafi 3, shtohet germa "s";

3.2 në pikën B), shtohen germat "n", "o" dhe "p";

4. Aneksi II, titullohet "*Udhëzime specifike për fondet e investimeve dhe pensioneve vullnetare"*:

4.1 Shtohet pika 1;

5. Aneks IV, ndryshohet *"Tabela 2. Kategorizimi i transaksioneve (kur është e aplikueshme)";*

6. Aneks V, pjesa 2,

6.1 Te rubrika 2.3 "Njih klientin tënd, vigjilenca e duhur dhe e zgjeruar", shfuqizohet pyetja 15;

6.2 Rubrika 2.5, ndryshohet,

6.2.1. titullohet "*Përputhshmëria me aktet ligjore dhe nënligjore për PPP/LFT";*

6.2.2 ndryshohen pyetjet 24 dhe 25;

6.3 Rubrika 2.6 ndryshohet, titullit i shtohet termi *"…/LFT";*

6.3.1 shtohet pyetja 31;

7. Shtohet Aneks VI, me titull *"Politikat dhe procedurat e pranimit të klientëve".*